

20111603497

L I G J
PËR NGARKIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISE ME HUA TE DOJÇE BANKA
DHE SITI BANKA SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA TË SIGURUAR ME GARANCI
TË BAZUAR NË POLITIKAT E BANKES NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM-BANKA BOTËRORE

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet me hua te Dojçe Banka dhe Siti Banka të siguruar me garanci të bazuar në politikat e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim-Banka Botërore në shumë prej 130 000 000 eurosh.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshje për hua të siguruar me garanci që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë, Dojçe Bankës, Siti Bankës dhe Bankës Nderkombetare për Rindërtim dhe Zhvillim-Banka Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni, do ta nënshkruaje ministri i Financave.

Neni 3

Kushtet dhe mënyra e aktivizimit të garancisë nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshje për garanci të që do të lidhet ndërmjet të Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim-Banka Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për garanci nga paragrafi 1 i këtij neni, do ta nënshkruaje ministri i Financave.

Neni 4

Huaja nga neni 1 i këtij ligji do të paguhet përnjëhere në ditën e arritjes që bie pesë vite nga dita e tërheqjes së huas.

Shkalla e kamatës do të përcaktohet si shkallë fikse e kamatës dy ditë para ditës së tërheqjes së mjeteve të huas nga neni 1 i këtij ligji, e do të llogaritet si shumë svop pesëvjeçar (për valutë euro) plus margjina. Shpenzimi i kamates do të paguhet në çdo gjysmëvjetor.

Në ditën e tërheqjes së mjeteve të huas nga neni 1 i këtij ligji, Republika e Maqedonisë do t'i paguajë Bankës Nderkombetare për Rindërtim dhe Zhvillim-Banka Botërore provizion të njëhershëm prej 0,25% nga shuma e garancisë së dhënë dhe provizion të njëhershëm në shumë prej 0,5% në vit nga shuma e garancisë, e llogaritur sipas vlerës së diskontuar gjatë kohëzgjatjes së garancisë.

Në ditën e tërheqjes së mjeteve të huas nga neni 1 i këtij ligji, Republika e Maqedonisë do t'i paguajë Dojçe Bankes dhe Siti Bankës provizion të njëhershëm në shumë prej 1,30% të vlerës së huas.

Neni 5

Shfrytëzues i mjeteve të huas nga neni 1 i këtij ligji është Ministria e Financave.

Neni 6

Republika e Maqedonisë huan nga neni 1 i këtij ligji do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".